

Komuna e Çairit, si bartëse e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me mundësitë e saj, filloi me hartimin e Planit Social të Komunës, i cili do të përmbajë masa dhe aktivitete për të ndihmuar dhe mbështetur grupet e marginalizuara të qytetarëve në Komunën e Çairit.

Ky dokument është i vlefshëm për 3 (tre vjet) - 2022-2025 dhe është në interes të të gjithë qytetarëve, shoqatave civile dhe palëve të tjera të interesuara që ofrojnë mbështetje dhe ndihmë sociale për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve të Komunës së Çairit.

Për këtë qëllim, Komuna e Çairit fton të gjitha shoqatat qytetare të interesuara, institucioneve, personave fizikë dhe juridikë që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale, si partnerë të barabartë, të kontribuojnë në hartimin e Planit Social, përmes dorëzimit të iniciativave, ideve dhe propozimeve të tyre për zhvillimin dhe promovimin e mbrojtjes sociale në nivel lokal, sipas nevojave të qytetarëve që janë në rrezik social.

Të gjithë personat/subjektet e interesuara mund të dorëzojnë iniciativat, propozimet dhe idetë e tyre në adresën elektronike: [ossz@cair.gov.mk](mailto:ossz@cair.gov.mk) , jo më vonë se 25.08.2022.